REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 116/20
Datë/Datum. 18.02.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **POLICIA E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit: Nr. i prokurimit: **214-19-5204-1-1-5**

Sa i përket tenderit për: **"Furinizim me ushqim për PK-në ri-tender ri-vlerësim"**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Hotel Galla SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Vrellë, A.I.R. Adem Jashari

(Adresa)

Lipjan — *(Vendi)*

14 000 — *(Kodi postar)*

+383 49-382 100 — *(Numri Telefonit)*

N/A — *(Numri i Faks-it)*

Kaltrina Zeka

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

rexhepzeka@bwhotelgalla.com
kaltrinazeka@bwhotelgalla.com

(Adresa elektronike)

18.02.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR HOTEL GALLA 70130378

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë:16.07.2019
Data e hapjes së ofertave dt. 01.08.2019
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 27.01.2020
Kërkesa për rishqyrtim dt:03.02.2020
Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dt:06.02.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së

** *Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar AK-ja me dt. 27.01.2020 na ka dërguar letrën standarde për tenderues të pasuksesshëm, me arsyetimin se nuk kemi ofruar tenderin me çmimin më të lirë, ndërsa ka rekomanduar për kontratë OE ''Beni Dona Plast'' SH.P.K., edhe pse është dashur të shpallet si tenderues të papërgjegjshëm.

Ju sqarojmë se tek ISO certifikatat e ofruara nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, përkatësisht certifikatat ISO 22000:2005 dhe ISO 9001:2015, dyshojmë që janë të falsifikuara sepse data e lëshimit, data e validitetit dhe **numri i certifikatave** është i njëjtë në të dyja këto certifikata, prandaj dyshojmë që janë të falsifikuara.

Prandaj kërkojmë nga ju që të vërtetoni pretendimin tonë në lidhje me këto certifikata ose

ta detyroni autoritetin kontraktues ti vërtetoj dyshimet tona në lidhje me certifikatat e OE të rekomanduar për kontratë "Beni Dona Plast" SH.P.K, duke kërkuar sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.
Këto dyshime janë edhe më të mëdha kur kemi parasysh faktin se secila certifikatë duhet të ketë numrin e veçantë, kurse në këtë rast dy certifikatat përmbajnë numër të njëjtë edhe pse këto certifikata janë me përmbajtje tjetër (ISO 22000:2005 dhe ISO 9001:2015).

Gjithashtu i njëjti operator ekonomik gjatë implementimit të kontratave të mëparshme nuk ka treguar seriozitet dhe profesionalizëm në implementimin e kontratave, duke qenë operator ekonomik i papërshtatshëm profesionalisht, prandaj nuk mund të jetë fitues i kësaj kontrate i njëjti operator ekonomik i cili nuk i ka përmbushur në tërësi dhe me profesionalizëm kontratat e mëparshme.

Në bazë të informacioneve që ne i posedojmë AK-ja ka bërë përpjekje për të bërë një verifikim të tillë por ne sa kemi njohuri, AK-ja nuk ka marrë përgjigje konkrete se certifikatat në fjalë janë valide.
Ne kemi bërë një verifikim në web faqen e KAS Cert e cila sipas verifikimit tonë është kompetente të lëshojë ISO certifikata 14001 dhe 18001, ndërsa po në këtë web faqe askund nuk figuron se i njëjti institucion lëshon ISO certifikata ISO 22000:2005 dhe ISO 9001:2015. **(Bashkangjitur keni foton e Web Faqes KAS Cert),** ku edhe në shikimin e komunikimit intern në mes të kompanisë në fjalë dhe AK-së sqarimi i kompanisë është se Beni Dona Plast SH.P.K e ka marrë ISO standardin 14001 (Shikoni komunikimet).

Ne me dt. 06.02.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim.

Në vendimin e dt.06.02.2020 të AK-së për refuzim të kërkesës tonë për rishqyrtim AK-ja e ka pranuar se ka kërkuar sqarim nga lëshuesi i këtyre certifikatave por që e kanë shënuar se nuk kanë marrë përgjigje shumë të qartë ndërsa AK-ja e pranon se përsëri i ka dërguar një kërkesë për sqarime shtesë lëshuesit të certifikatave KAS cert international por pastaj nuk kanë marrë asnjë përgjigje nga ky institucion.

Duke u bazuar në faktet e lartpërmendura rezulton se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, prandaj rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë konform nenit 7 të LPP-së.

Gjithashtu në këtë aktivitet të prokurimit, nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët,** konform nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **Hotel Galla SH.P.K.**
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*